



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

PLANI PËR INTEGRITET
I SISTEMIT PROKURORIAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2024 – 2026)

26 janar 2024

PËRMBAJTJE

.....	1
Republika e Kosovës	1
Hyrja	3
Kronologjia e grupit punës	3
Deklarata e integritetit	5
PERMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT	6
Qëllimet e Planit të Integritetit	6
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit	7
Metoda e vlerësimit të rrezikut	7
Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	8
Fushat e rrezikut	9
Fushat e përgjithshme të rrezikut	9
Fushat specifike të rrezikut.....	9

Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e planeve të integritetit”, të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i Integritetit është një dokument i brendshëm trevjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda secilit institucion dhe ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të institucion.

Plani rritetson përkushtimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të sistemit prokurorial.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Kronologjia e aktiviteteve

Bazuar në nenin 25 të Ligjit nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit më datë 17 janar 2024, titullari i institucionit, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka nxjerrë vendimin për caktimin e Grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit, në përputhje me përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, në përbërje prej 15 anëtarësh.

Vendimi është nxjerrë me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, në raport me detyrimet e institucionit.

Aktiviteti i Grupit punues ka qenë përgatitja e një programi për hartimin e Planit të Integritetit, përmes të cilit janë informuar punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e hartimit të Planit të Integritetit, si dhe të vlerësojë gjendjen aktuale të funksionimit të institucionit dhe të analizojë masat ekzistuese për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, të vlerësojë intensitetin e rrezikut të korrupsionit, të propozojë afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e masave përmirësuese që ulin rrezikun e korrupsionit, si dhe të informojnë punonjësit për situatën në institucion, duke vlerësuar intensitetin e rrezikut të korrupsionit dhe planin e zbatimit të masave përmirësuese.

Grupi punues ka përfunduar hartimin e Planit të Integritetit më 26 janar 2024, sipas afatit të përcaktuar me vendim.

Rëndësia e hartimit dhe të miratimit të Planit të Integritetit, si një dokument që paraqet rezultatin e vetëvlerësimit dhe ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, është të ruajë dhe përmirësojë integritetin e institucionit duke thjeshtuar procedurat, duke forcuar llogaridhënien, kontrollin e kompetencat diskrecionale, edukimin, forcimin e etikës, krijimin e një sistemi efektiv kontrolli dhe eliminimin e praktikave joefikase.

Grupi punues gjatë punës së tij ka vepruar sipas udhëzimeve dhe procedurave standarde, të përcaktuara me metodologjinë për planet e integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas dorëzimit të draftit të parë në Agjenci, janë pranuar disa rekomandime.

Si rrjedhojë e kësaj, me mbështetjen e UNDP-së është realizuar një punëtori nga data 6 deri më 8 mars 2024, në përbërje gjithëpërfshirëse nga menaxhmenti pothuajse i të gjitha niveleve në sistemin prokurorial, si dhe anëtarë të Këshillit Prokurorial, prej ku edhe është finalizuar ky plan integriteti.

Deklarata e Integritetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës (tutje KPK) shpreh zotimin dhe përgjegjësinë ndaj vlerave të integritetit personal dhe profesional. Me këtë deklaratë, angazhohet për të respektuar dhe përmbushur standardet më të larta etike dhe ligjore në kryerjen e detyrave të sistemit prokurorial.


KPK synon në ngritjen e vazhdueshme të profesionalizmit, efikasitetit dhe menaxhimit të sistemit prokurorial, fuqizimin e pavarësisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës, duke u mbështetur gjithnjë në kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të ofrojë mbikëqyrje, menaxhim, analiza, politika efektive dhe administrim të nivelit të duhur për të siguruar që Prokurori i Shtetit ka të gjitha burimet që i nevojiten për të ofruar shërbime prokuroriale me performancë të lartë, llogaridhënëse dhe të qasshme për qytetarët e Kosovës.

Plani i Integritetit i KPK-së është rezultat i një analize të detajuar të kuadrit ligjor dhe rregullator të këtij institucioni, proceseve të punës si dhe risqeve të integritetit që mund të shfaqen në faza të ndryshme të proceseve të punës.

Plani i Integritetit i KPK-së është një dokument që paraqet standarde profesionale masat që duhet të zbatohen nga punonjësit e sistemi prokurorial dhe shërben si një mjet për të menaxhuar dhe vlerësuar riskun e integritetit. Ky instrument përmirëson cilësinë e vendimmarrjes, dhe menaxhimin institucional në çdo hallkë të tij duke filluar nga proceset e thjeshta të punës e duke vijuar deri në menaxhimin të nivelit të lartë. Gjithashtu, shërben si mjet për të promovuar etikën dhe integritetin brenda sistemit si dhe duke e përdorur si dokument operativ, ku jepen masa konkrete për përmbushjen e objektivave për forcimin e integritetit në institucion. Plani do të kontribuojë në realizimin e objektivave organizative të sistemit prokurorial duke marrë në konsideratë menaxhimin e riskut të integritetit dhe masat konkrete për të trajtuar risqet e evidentuara.

Ardian Hajdaraj – Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Përmbajtja e Planit të Integritet përmban elementet e mëposhtëm:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të KPK-së ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e KPK dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të Planit të Integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- rritja e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- identifikimi i rreziqeve dhe i masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- përmirësimi i kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- mbajtja e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale dhe
- rritja e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga institucioni.

Qëllimet e Planit të Integritetit

Qëllimet e Planit të Integritetit janë, si vijojnë:

- sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- llogaridhënie publike dhe transparencë;
- rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet nga disa faza, si në vijim:

- Faza e parë: Drejtuesi/personi përgjegjës i institucionit merr vendim për emërimin e një koordinatori dhe Grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga një numër i arsyeshëm anëtarësh, në varësi të kompleksitetit të institucionit ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).
- Faza e dytë: Grupi punues përpilon pyetësin gjithëpërfshirës dhe mund të realizojë intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Mbi bazën e rezultatit të pyetësit përcaktohen fushat e rrezikut dhe bëhet identifikimi i rreziqeve.
- Faza e tretë: Grupi punues përdorë të dhënat e siguruar për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe për të adresuar cenueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, institucioni publikon Planin e Integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën trevjeçare.

Metoda e vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasoja e cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose joetike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët, i mesëm dhe i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1. Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /ndikimi	I lartë	10																	
		9																	
		8																	
	I mesëm	7																	
		6																	
		5																	
		4																	
	I vogël	3																	
		2																	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10								
		I ulët			I mesëm				I mesëm										

Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi)	Probabiliteti/Gjasat
--	-----------------------------

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin - gjasën me pasojën - ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lart.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e mëposhtme:

I ulët	I mesëm	I mesëm
1 - 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit si Zyrtar përgjegjës i KPK-se dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive në hartimin dhe në zbatimin e tij dhe procedurat janë kuptuar, si dhe ky plan integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm, përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetet e rrezikut, si dhe kanë identifikuar se cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i planit bëhet në përputhje me orarin dhe rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit pas hartimit të nga zyrtari përgjegjës në institucion duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- fusha e menaxhimit financiar;
- fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit;
- komunikimi dhe informimi;
- ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve etj.

Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e institucionit.

Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:

- prokurimi publik;
- administrata e sistemit prokurorial;
- procesi i menaxhimit të lëndëve dhe dokumenteve në prokurori;
- planifikimi;
- standardet e kontrollit administrativ;
- vlerësimi i performancës;
- ofrimi i shërbimeve;
- menaxhimi i projekteve/kontratave.

PLANIT I INTEGRITETIT

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut		Veprimi ndaj rrezikut			
ishia e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	rrezikut Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati realizimit
ishia e enaxhimit nancier	Regjistrimi i transaksioneve në baza kohore dhe procedurat e autorizimit të pagesave miratohen nga zyrtarët kompetent	Raportimi tremujor	7	7	49	Vlerësimi dhe analizimi i raportit me të gjeturat	ZKF/ZKA	Raporte periodike 2024-2026

	Planifikimi joadekuat i buxhetit	Ligjet dhe aktet nënligjore					Të sigurojë pjesëmarrjen e të gjitha njësive relevante gjatë planifikimit të buxhetit. Organizimi i trajnimeve dhe i punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit.	ZKA	Janar-mars 2024-2026
	Shpenzimi i buxhetit në mënyrë joadekuate dhe jomjaftueshëm transparent						Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve Raportimi i rregullt për shpenzimet e buxhetit Publikimi i planit të shpenzimeve në uebportal	ZKA	Raportimi periodik 2024-2026
	Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve të sistemit prokurorial.						Përditësimi i regjistrit të brendshëm të aseteve të sistemit prokurorial (E-pasuria)	ZKA/DSHP/DBF	12 muaj 2024-2026
		7	7	49					
		7	7	49					
		5	7	35					

Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore	Plani i personelit dhe mosplotësimi i vendeve të punës me staf	Dokumenti i hartuar vlerësim nevojave	5	6	30	Zhvillimi dhe miratimi i planit të personelit Të bëhet analiza e nevojave për trajnime Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve	DBNJ/ZKA Zyra Trajnimeve	Janar-dhjetor
	Vlerësimi i kriterëve për procesin e rekrutimit	Ligji dhe aktet nënligjore në zbatim	7	7	49	Trajnimi i komisioneve rekrutuese në fushat e caktuara	ZKA/DBNJ/ Komisioni	Janar-dhjetor
Fusha e kontrollit, auditimit	Auditimet e bazuara në rreziqe, si: financat, burimet njerëzore, prokurimi, menaxhimi i pasurive, ZMNV-ja, PS-ja	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit.	5	6	30	Kontrollet sistematike në fushat përkatëse dhe zbatimi i rekomandimeve	Departamentet dhe njësitë përkatëse	Janar-dhjetor
Komunikimi dhe informimi	Plasimi i informatave jo te sakta dhe jo profesionale.	Raportet 24-orëshe	4	4	16	Buletini mujor	pas hartimit të	Janar-dhjetor

	Perceptim jo i mirë në mungesë të raporteve të publikuara për mungesë të transparencës për sistemin prokurorial	Grupet punuese për përcaktimin e kritereve dhe specifikave për zhvillimin e uebportalit. Rregullorja për komunikim me publikun.	5	5	5	Rishikimi i Strategjisë për Komunikim Publik Krijimi i protokolleve për publikim	Zyrtari për Komunikim Publik	Janar dhjetor
	Postimi në kohë reale në uebportal të sistemit prokurorial	Përditësimi i informatave në uebportal	5	6	30	Zhvillimi i platformës për komunikim publik	Zyrtari për Komunikim Publik	Janar dhjetor
Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve	Rregullore për Administrimin e të Dhënave Dokumenteve Vendimi për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve të cilat nxjerrën nga KPK		6	6	36	Akt nënligjor Lista me afat të ruajtjes së dokumenteve		Janar-dhjetor

	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemin e drejtësisë		7	8	56	Përgatitja e procedurës standarde për sigurinë e informacionit të të dhënave Avancimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së IT-së	Departamenti IT-së	Janar dhjetor	–
Prokurimi publik	Përgatitja joefikase e specifikimeve të tenderit	Ligjet dhe aktet nënligjore	7	7	49	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e tenderëve si dhe trajnim i zyrtarëve përgjegjës (iniciuesit-hartuesit)	ZKA/njësite kërkuese Njësia e Prokurimit	Janar dhjetor	–
	Menaxhimi joefikas i kontratave/projekteve		7	7	49	Sigurimi i resurseve të nevojshme për menaxhimin e kontratave dhe trajnimi i tyre			

Procesi i nënaxhimit të ëndëve dhe lokumenteve në prokurori	Moszbatimi i plotë i SMIL-it	Rregullorja për Menaxhimin e Lëndëve përmes SMIL-it	7	6	42	Zbatimi i plotë i SMIL-it Përgatitja e analizës për largimin e regjistrir fizik Gjenerimi i raporteve statistikore nga SMIL-i dhe publikimi i tyre në uebportal	KPK	Janar- dhjetor
	Unifikimi i formave dhe i praktikave	Doracaku me forma standarde të akteve të aprovuara nga KPK-ja	6	6	36	Hartimi i udhëzuesve për unifikimin e formave të shkresave	KAP	Janar- dhjetor
Vlerësimi i performances	Mungesa e vlerësimit Mosefikasiteti në pune	Aktet nënligjore në fuqi	7	6	42	Përgatitja e një analize të re në sistemin aktual të vlerësimit të performancës Ndryshimi i sistemit të vlerësimit të performancës Përcaktimi i saktë i peshës së secilit kriter vlerësues	KPK/ZKA/KVPP dhe Koordinatori	Janar- dhjetor

Ofrimi i shërbimeve	Mosofrimi i shërbimeve në kohë	Takimet qytetarët	me	5	4	20	Raportimi i rregullt të organet kompetente	KPK	Janar-dhjetor
		Trajtimi i kërkesave dhe i ankesave	i						